



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Dr. Ali Topalli

Nr. Prot. 1183
Datë 24.09.2020

Në mbështetje të nenit 133 pika 2 të Statutit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 18.9.2020, aprovoi:

Rregullore mbi përgjegjësinë dhe procedurën disiplinore të studentëve

Neni 1

Qëllimi

Me Rregulloren mbi përgjegjësinë disiplinore të studentëve (në tekstin e mëtejme Rregullore) rregullohet procedura lidhur me përcaktimin e shkeljeve disiplinore të studentëve të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (në tekstin e mëtejme Universiteti), vërtetimi dhe përcaktimi i gjendjes faktike dhe fajësia e kryerësit, afatet për ndërmarrjen e veprimeve, mbrojtja e studentëve dhe ekzekutimi i masave disiplinore.

Neni 2

Obligimet e studentëve

- (1) Studentët janë të obliguar që t'i përmbahen dispozitave të Statutit dhe akteve tjera normative të Universitetit, respektivisht njësive akademike, t'i përmbahen rregullave të mirësjelljes, si dhe të ruajnë reputacionin e tyre studentor
- (2) Studentët duhet t'u përmbahen obligimeve që dalin nga aktet normative të Universitetit, gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, konsultimeve, kollokviumeve, provimeve. Në këtë kuptim, shkelje disiplinore e studentit konsiderohet çdo tentim apo veprim i tij, të cilin e përdor për të kopjuar apo falsifikuar, për të marrë dhe dhënë informata të paautorizuara nga studentët e tjerë, me qëllim të plotësimit të testit apo të kollokviumit në mënyrë të kundërligjshme.
- (3) Gjatë mbajtjes së provimit, kollokviumit dhe testeve, studentëve:
 - U ndalohet rreptësisht të kenë me vete çanta të çfarëdo lloji, duke i përfshirë edhe ato të femrave;
 - U ndalohet rreptësisht të marrin me vete libra, fletore, letërza dhe çfarëdo materiali tjetër të karakterit kopjues;
 - U ndalohet rreptësisht të kenë me vete telefona ose pajisje të ngjashme elektronike. Këto pajisje nuk lejohen edhe nëse janë të fikura. Pajisjet që gjenden te studentët do të sekuestrohen dhe do të dorëzohen tek komisioni disiplinor, i cili do ti mbajë për aq kohë sa do të zgjasë edhe masa e ndëshkimit;
 - U ndalohet rreptësisht të bëjnë ndërrimin e testeve mes tyre;
 - Studentët obligohen të kontrollojnë bankën e tyre në tërësi, e nëse ka ndonjë material-letër apo është shënuar diçka, menjëherë ta njoftojnë përgjegjësin e sallës në mënyrë që të hiqet ai material apo përshkrim.

Neni 3

Shkeljet disiplinore

Shkelje disiplinore e studentit konsiderohet secili rast i mosrespektimit të obligimeve nga ana e studentit të përmendura në nenin 2 të Rregullores. Shkelje të rënda disiplinore konsiderohen posaçërisht:

- (1) a) Veprimet që shkaktojnë vepër penale për të cilat parashihet ndjekje penale sipas detyrës zyrtare;
- b) Veprimet që shkaktojnë vepër penale që është shkaktuar ndaj mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve dhe punëtorëve tjerë të Fakultetit dhe Universitetit ose ndaj studentëve tjerë;
2. Shkatërrimi ose dëmtimi me qëllim i pasurisë të Universitetit ose fondit të librave në Bibliotekë;
3. Prishja e rendit dhe shkelja disiplinore lidhur me njërin prej formave të mësimit ose provimit;
4. Keqpërdorimi i hapësirave, materialeve, pajisjeve të informatikës dhe pajisjeve tjera të Fakultetit;
5. Shkelje të rënda të rregullave të mirësjelljes ndaj mësimdhënësve, punëtorëve tjerë të Universitetit dhe Fakulteteve apo ndaj studentëve, qytetarëve dhe organeve dhe organizatave tjera në objektet e fakultetit dhe të universitetit, si dhe në objekte tjera zyrtare apo vende publike tjera.

Neni 4 Për shkeljet disiplinore janë përgjegjës të gjithë studentët e studimeve themelore, studimeve të masterit dhe të studimeve të doktoratës.

Neni 5

Masat për shkeljet disiplinore

Studentëve për shkeljet disiplinore mund t'ju shqiptohen këto masa:

1. Vërejtje me shkrim,
2. Paralajmërimi i fundit para se të përjashtohet,
3. Përjashtim nga studimet deri në dy vjet,
4. Përjashtim i përhershëm nga Fakulteti.

Masat e përjashtimit nga Fakulteti, të cekura në pikën 3 dhe 4 mund të shqiptohet vetëm për shkelje të rëndë disiplinore ose në rastet e përsëritjes së shkeljeve disiplinore.

Masa disiplinore nga pika 3 nënkupton ndalimin e regjistrimit të vitit dhe ndalimin e hyrjes në provime dhe pjesëmarrjes në format tjera të mësimit.

Neni 6

Gjatë shqiptimit të masës për shkeljen e obligimeve të studentëve merren parasysh veçanërisht pesha e shkeljes së detyrës, pasojat e saj, shkalla e përgjegjësisë së studentit, sasia e dëmit, sjelljet e këqija nga të cilat është shkaktuar shkelja, sjelljet e mëparshme dhe sjelljet e studentit pas shkeljes së bërë.

Neni 7 Ndjekja për shkak të shkeljes disiplinore nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar gjashtë (6) muaj prej ditës kur është bërë shkelja disiplinore. Në qoftë se me rastin e shkeljes disiplinore është kryer edhe vepër penale, vjetërsimi i shkeljes është i barabartë me vjetërsimin e veprës penale. Vjetërsimi i shkeljes disiplinore nuk rrjedhë në periudhën prej 1 korrikut deri më 31 gusht të vitit kalendarik.

E drejta për ekzekutimin e masës së shqiptuar, sikurse në nenin 5 pika 1 dhe 2, vjetërsohet 30 ditë nga dita kur vendimi mbi shqiptimin e masës është bërë i plotfuqishëm. E drejta për ekzekutimin e masës së shqiptuar, sikurse në nenin 5, pika 3 dhe 4 vjetërsohet 60 ditë nga dita kur vendimi mbi shqiptimin e masës është bërë i plotfuqishëm.

Neni 8

Emërimi i komisionit disiplinor dhe komisionit të ankesave

Lidhur me lëndët e përgjegjësisë disiplinore të studentëve vendos Komisioni disiplinor për studentë dhe Komisioni i ankesave si organi i shkallës së dytë.

Komisioni disiplinor dhe Komisioni i ankesave përbëhen me nga 3 (tre) anëtarë, nga 2 (dy) anëtarë i zgjedhë Këshilli i Fakultetit nga radha e mësimit apo asistentëve në marrëdhënie të rregullt pune kurse anëtarin e tretë e zgjedhë Këshilli i studentëve nga radha e studentëve të fakultetit. Në mënyrën e njëjtë zgjidhen edhe kryetari dhe anëtarët rezervë të Komisioneve, të cilët do të zëvendësojnë anëtarët e komisionit në mungesë.

Anëtarët e Komisioneve, nga radhët e mësimit apo asistentëve, zgjidhen për mandat 4 vjeçar, kurse anëtarët studentë zgjidhen për mandat njëvjeçar.

Neni 9

Procedura disiplinore

1. Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore respektivisht paraqitjen e një shkelje të dyshuar e paraqet dekani te Komisioni.
2. Propozimin nga paragrafi 1 të këtij neni, dekani e paraqet me nismën e vet ose me kërkesë të personit të interesuar, nëse konsideron se ajo është e justifikuar.
3. Për të përgatitur paraqitjen e shkeljes së dyshuar, dekani ose nëpërmes zyrtarit të vet, sipas nevojës, mund të sigurojë deklarata me gojë ose me shkrim të shkelësit të dyshuar apo personave tjerë dhe të mbledhë dokumente dhe prova të tjera. Lidhur me intervistimin e shkelësit të dyshuar hartohet procesverbal i intervistës hetuese. Provat e mbledhura mund të përdoren gjatë shqyrtimit.

Neni 10

Propozimi për fillimin e procedurës i dorëzohet Komisionit disiplinor. Propozimi përmban informacion në lidhje me kryerësin e dyshuar të një shkelje disiplinore, përshkrimi faktik i veprës, provat e propozuara për t'u paraqitur gjatë shqyrtimit, propozimin që shkelësit të dyshuar ti shqiptohet masa disiplinore në pajtim me këtë Rregullore, arsyetimi dhe të dhëna tjera të nevojshme për kryerjen e duhur të procedurës.

Komisioni disiplinor, nëse e konsideron se propozimi është i bazuar, cakton seancën për shqyrtim dhe një kopje të propozimit, së bashku me ftesë ia dërgon shkelësit të dyshuar.

Neni 11

Komisioni ia dorëzon studentit dhe propozuesit vendimin për fillimin e procedurës. Nëse Komisioni vendos të mos zhvillojë hetime, nuk do të nxjerrë një vendim të veçantë për të iniciuar procedurën, por menjëherë do të bëjë njoftimin për shkelësin e dyshuar. Në këtë rast, procedura llogaritet se është iniciuar me caktimin e seancës.

Vendimi për fillimin e procedurës nuk mund të apelohej.

Neni 12

Procesi fillon kur Komisioni konsideron se propozimi është i bazuar dhe kur ndërmerret ndonjë veprim në lidhje me zbatimin e tij.

Me qëllim për të përgatitur lëndën, komisioni mundet, pa zbatimin e një hetimi, të mbledhë informacione shtesë mbi shkeljen e kryer disiplinore dhe shkelësin e dyshuar ose për nxjerrjen e vendimit për të kryer një hetim.

Në qoftë se konsideron se nuk ka vend për fillimin e procedurës, komisioni do të lëshojë një vendim duke ia dorëzuar propozuesit dhe studentit.

Neni 13

Shkresat e lëndës dhe vendimi i dorëzohen Dekanit, nëpërmes zyrës së arkivës në Fakultetin përkatës, kurse studentit dorëzimi i bëhet duke i dërguar në adresën e banimit në studime apo në adresën e vendbanimit të përhershëm me postë të regjistruar ose dorëzim në Fakultet.

Nëse studenti shmang pranimin e shkresave, ose në Fakultet nuk ka paraqitë adresën e saktë të vendbanimit, dorëzimi bëhet duke bërë shpalljen e shkresave në tabelën e shpalljeve në fakultet, dhe pas kalimit prej tetë ditësh prej ditës së shpalljes së njoftimit, konsiderohet se shkresat i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt.

Neni 14

Studenti ka të drejtë për avokat mbrojtës gjatë gjithë procedurës. Njoftimi për këtë i jepet studentit në vendimin për fillimin e procedurës, ose në ftesën për shqyrtimin kryesor, nëse në rastin konkret nuk janë zhvilluar hetime.

Avokati mbrojtës ka të drejtë të marrë pjesë kur merret në pyetje studenti si dhe në të gjitha shqyrtimet e procesit për të ndërmarrë masat e nevojshme për të mbrojtur studentin.

Shkresat dhe ftesat nuk i dërgohen personalisht avokatit mbrojtës, por për këtë do ta informojë studentin.

Neni 15

1. Shqyrtimi para Komisionit disiplinor fillon me leximin e paraqitjes së shkeljes së dyshuar.
2. Pas kësaj Komisioni do të ftojë studentin, ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u deklaruar mbi të dhënat e propozimit dhe të paraqesë mbrojtjen e tij.
3. Kryetari i Komisionit duhet ta njoftojë studentin, ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore, që nuk është e domosdoshme për t'u deklaruar apo për të dhënë shpjegime mbi të dhënat e paraqitura në propozimin për iniciimin e procedurës ose për të paraqitur mbrojtjen e tij.
4. Propozimin për iniciimin e procedurës disiplinore, në seancë e përfaqëson i autorizuari i dekanit.
5. Dëshmitë dhe provat në Komision paraqiten sipas radhës së caktuar nga kryetari i Komisionit disiplinor.
6. Mbi rrjedhën e seancës do të mbahet procesverbali me shkrim nga njëri prej anëtarëve të Komisionit apo nga një procesmbajtës i veçantë i caktuar.
7. Gjatë kohës kur studentin, ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore, paraqet deklaratën e vet, dëshmitarët nuk do të jenë prezentë në seancë.
8. Kryetari i Komisionit disiplinor duhet të paralajmërojë secilin dëshmitar, për obligimin që të dëshmojë të vërtetën dhe për pasojat e dëshmisë së rreme. Nëse është e nevojshme, Komisioni disiplinor do të përballë dëshmitarët me njëri-tjetrin dhe çdo dëshmitar me studentin, kundër të cilit zhvillohet procedura disiplinore.
9. Pas marrjes së dëshmitarëve në pyetje, do të lexohen shkresat e lëndës, dokumente dhe deklarata të personave të cilët nuk marrin pjesë në seancë si dhe mund të dëgjohen edhe ekspertët.
10. Ndalohen pyetjet sugjестive dhe kapçioze ndaj të gjitha palëve dhe dëshmitarëve në këtë procedurë.
11. Studenti ndaj të cilit zhvillohet procedura dhe i autorizuari i dekanit mundën, deri në fund të shqyrtimit, të kërkojnë prezantimin e fakteve të reja dhe të paraqesin prova të reja, kurse Komisioni disiplinor mund të vendosë për të paraqitur dëshmi dhe prova të reja, të cilat nuk janë paraqitur më herët, ose nga të cilat propozuesi është tërhequr.
12. Pas përfundimit të procedurës së provave, kryetari i Komisionit disiplinor ia jep fjalën e fundit të autorizuarit të dekanit, dhe më pas studentit ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore ose avokatit të tij mbrojtës.

Neni 16

Pas shqyrtimit me gojë dhe publik, Komisioni, si shkallë e parë, i propozon Këshillit të Fakultetit përkatës lidhur me nxjerrjen e vendimit dhe shqiptimin e masës disiplinore për shkak të shkeljes disiplinore të studentit.

Këshilli i Fakultetit mund të shqiptojë masën disiplinore vetëm nëse kryesi i shkeljes është dëgjuar në seancë nga Komisioni disiplinor. Përbashimisht, masa mund të shqiptohet edhe nëse kryesi nuk është dëgjuar, ndërsa në seancë nuk ka marrë pjesë edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt.

Neni 17

Përmbajtja e vendimit

Vendimi i marrë në procedurë disiplinore i dorëzohet studentit dhe dekanit të fakultetit. Vendimi mbi shqiptimin e masës duhet të përmbajë hyrjen, dispozitivin, arsyetimin si dhe këshillën juridike për të drejtën e ankimimit të vendimit nga palët.

Neni 18

E drejta e ankesës

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë nga Komisioni Disiplinor respektivisht Këshillit të njësive akademike.
2. Ankesa për shkelje të lehta i dorëzohet Komisionit të ankesave të themeluar nga Këshilli i njësive akademike, brenda 15 ditëve të punës pas shqiptimit të tyre.
3. Vendimi i komisionit të ankesave për këto shkelje është përfundimtar.
4. Ankesa për shkelje të rënda i dorëzohet në Komisionin përkatës të themeluar nga Senati.
 5. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në gjykatën kompetente.
 6. Ankesa e parashtruar brenda afatit të përcaktuar e shtynë ekzekutimin e vendimit mbi shqiptimin e masës disiplinore ndaj studentit.

Neni 19

Ekzekutimi i vendimeve

Ekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme të nxjerra në procedurë disiplinore e bën dekani i fakultetit.

Fakulteti mban evidencë të veçantë për të gjitha masat e shqiptuara disiplinore.

Vendimi mbi masën e shqiptuar studentit përjashtim nga Fakulteti vendoset edhe në dosjen e studentit.

Me përjashtimin e përhershëm të studentit nga Fakulteti, studentit i pushon statusi i studentit.

Neni 20

Dispozitat përfundimtare

Për çështjet të cilat nuk janë paraparë në këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e Ligjit mbi procedurën penale të Republikës së Kosovës, në mënyrë të kuptueshme, përveç dispozitave të sjelljes me dhunë.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. dr. Ali Topalli

